PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës 1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare;
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës 1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit

Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT**Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë**
(në rast BOE): _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
				Çmimi total	_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					

Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik "....." për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik "....." të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6 .

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve:

1. Të përgjithshme

Për realizimin e ndërlidhjes së të gjitha strukturave spitalore dhe qendrave rajonale në një rrjet kombëtar online, është e nevojshme që, të sigurohet një infrastrukturë e dedikuar optike e qëndrueshme dhe me kapacitet të mjaftueshëm midis Zyrës Qendrore të OSHIS Sh.a. (Kashar) dhe 12 strukturave rajonale spitalore në të gjithë Republikën e Shqipërisë (në total 13 lokacione fizike).

Ky rrjet duhet të jetë i sigurt, i izoluar dhe me parametra teknike që garantojnë transmetimin në kohë reale të të dhënave kritike, shërbimeve multimediale (data, imazh, voice, video) dhe menaxhimin e fluksit të punës për Sistemin Kombëtar të Shërbimit të Integruar të Sterilizimit dhe Furnizimit të Pajisjeve Kirurgjikale. Infrastruktura duhet të mbështesë proceset jetike të skanimit, gjurmueshmërisë (tracking) së seteve kirurgjikale dhe komunikimit të pandërprerë dhe pa vonesa mes njërive.

Qëllimi i kësaj kontrate është ofrimi dhe mirëmbajtja e **shërbimit Fibër LAN-to-LAN Layer 2**, ndërmjet 13 lokacioneve fizike (sipas tabelës së lokacioneve) dhe **Internet i dedikuar** pranë zyrave qendrore. Kjo infrastrukturë do të mundësojë lidhjen e sigurt të nyjeve të OSHIS Sh.a. për një periudhë prej 24 muajsh (dy vjet).

Bazuar në VKM-në nr. 710, datë 21.08.2013, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, mirëmbajtja dhe gatishmëria teknike duhet të jetë maksimale për të garantuar standardet e sigurisë pacientit.

Më poshtë jepet lista e pikave për të cilat kërkohet lidhja online:

SHËRBIMI 1: INTERNET I DEDIKUAR (KASHAR)

Operatori Ekonomik duhet të ofrojë shërbim Interneti të dedikuar (Dedicated Internet Access) për lokacionin qendror në Kashar (Adresa: Tiranë, Kashar, Mëzez, Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 5).

Shërbimi	Adresa / Lokacioni	Kapaciteti i Garantuar
Internet	Kashar	50 Mbps

Kërkesat specifike për Internetin:

- Lidhja duhet të jetë e dedikuar dhe Simetrike (Raporti Download/Upload 1:1).
- Të ofrohen adresa IP Publike statike sipas nevojave të institucionit.

SHËRBIMI 2: INTRANET (LIDHJE FIBER LAYER-2 LAN-TO-LAN)

Operatori Ekonomik duhet të ofrojë rrjet transmetimi të dhënash (LAN-to-LAN). ndërmjet spitaleve rajonale dhe nyjes qendrore në Kashar sipas tabelës së lokacioneve. Rrjeti duhet të funksionojë absolutisht në Layer-2 (VLAN Transparent) për të mundësuar shtrirjen e rrjetit lokal pa asnjë ndërhyrje apo manipulim të paketave (routing) nga ana e operatorit.

TABELA E LOKACIONEVE, ADRESAVE DHE KAPACITETEVE


Më poshtë paraqitet lista e lokacioneve unike me kapacitetet përkatëse për linjat Primare dhe Backup:

Nr.	Lokacioni / Institucioni	Adresa e Saktë	Kapaciteti Primar	Kapaciteti Backup
1	Nyja Qendrore (Kashar)	Mëzez, Autostrada Tiranë-Durrës, Km.5	100 Mbps	100 Mbps

2	Qendra Spitalore Universitare Nene Tereza (QSUNT)	-	100 Mbps	100 Mbps
3	Spitali Shefqet Ndroqi (Sanatoriumi)	-	50 Mbps	-
4	Spitali Ushtarak (Trauma)	-	50 Mbps	-
5	Mat. Koço Gliozheni	-	50 Mbps	15 Mbps
6	Spitali Rajonal Durrës	-	50 Mbps	-
7	Spitali Rajonal Vlorë	-	50 Mbps	-
8	Spitali Rajonal Shkodër	-	50 Mbps	-
9	Spitali Rajonal Burrel	-	50 Mbps	15 Mbps
10	Spitali Lushnje	-	50 Mbps	-
11	Spitali Rajonal Dibër	-	40 Mbps	15 Mbps
12	Spitali Korçë	-	15 Mbps	-
13	Spitali Rajonal Tropojë	-	10 Mbps	-

*Shënim: Në pikat ku kërkohet linjë Backup, ajo duhet të dorëzohet përmes një rrugëtimi fizik të ndryshëm (redundant) nga linja Primare.

SKEMA E RREJTIT TË DHËNAVE DHE INTERNETIT



Shërbimet e specifikuar më sipër duhet të sigurohen dhe menaxhohen dhe të plotësojnë indikatorët e cilësisë të detajuara më poshtë.

Indikatorët e cilësisë

1. Operatori duhet të zoterojë çertifikatën ISO 9001 (Cilësia), ISO 20000-1:2018 (Menaxhimi i shërbimit), ISO 27001 (Siguria e informacionit) dhe ISO 22301 (Vazhdimësia e biznesit)
2. Operatori duhet të ketë të paktën 2 (dy) lidhje ndërkombëtare për shërbimin e Internetit.
3. Operatori duhet të paraqesë skemat përkatëse për të gjitha lidhjet fizike nga vendodhja e secilit lokacion deri në Pikën e Prezencës (POP) të Operatorit në qytetin përkatës sipas tabelës së mësipërme.
4. Ofruesi duhet të aplikojë dhe të garantojë teknika të cilësisë së shërbimit duke optimizuar transferimin e të dhënave dhe duke mundësuar parametrat e duhur për aplikimin e një rrjeti të konvergjuar me përmbajtje të dhënash.
5. Rrjeti i ofruar duhet të garantojë “point to point full-duplex data transmission connection” përmes Nyjes Qëndrore të OSHIS në Kashar me spitalet rajonale ne rrethe sipas tabelës së mësipërme.
6. Vonesa e transmetimit (Round Trip Delay) për të gjithë lidhjet midis Nyjes Qëndrore të OSHIS në Kashar me spitalet rajonale ne rrethe rrethe duhet të jetë me e vogël se 15 ms.
7. Rrjeti i Operatorit duhet të jetë bazuar në teknologjinë MPLS.
8. Rrjeti i operatorit duhet të jetë i mbrojtur në nivel backbone.
9. Rrjeti i Operatorit duhet të jetë në gjendje të suportoje kapacitete të larta mbi 1 Gbps.
10. Disponueshmëria e shërbimit CIR 99.5%.
11. Operatori duhet të ofrojë një SLA prej të paktën 99.5%
12. Operatori duhet të jetë i regjistruar pranë regjistrimit të AKEP për ofrimin e shërbimit, për këtë të paraqesë autorizimin përkatës.
13. Operatori duhet të sigurojë mbrojtje nga sulmet DDoS. Mbrojtja nga sulmet DDoS do të ofrohet për linjen e internetit në site primar nepermjet monitorimit, njoftimit dhe pastrimit automatic të sulmeve DDoS që trafikohen në rrjetin e Institucionit duke ofruar kështu; mbrojtje të serverit, mbrojtje të infrastruktures BGP, mbrojtje në baze volumetrike, rrugëzim (routing) të trafikut drejt një “Scrubbing Center” qendëzim pastrimi, i cili duhet të ketë lidhje Intranet Layer 2 nga operatori ekonomik për të rrugëzuar të gjithë trafikun në rast sulmesh. Monitorim 24/7. Suport nga specialiste me eksperiencë të mëparshme në këtë

shërbim. Kjo pike ndikon në mbajtjen ndaj sulmeve që mund të drejtohen institucionit tëne duke mundësuar kështu filtrimin që në nisje.

Instalimet e Rrjetit

1. Mënyra e ofrimit të këtij shërbimi të jetë me transmetim me fibër optike.
2. Kapacitetet e rrjetit për çdo pikë duhet të jenë simetrike, dhe me mundësi zgjerimi dhe konfigurimi me kapacitete të ndryshme.
3. Ofertuesi duhet të mbështesë shërbimin edhe në një rrjet dytësor (Intranet dhe Internet) që do të shërbejë si zgjidhje backup për garantimin e komunikimit të pandërprerë ofertues-datacenter 2 në Nyjen Qëndrore të OSHIS dhe lokacionet e mësipërme nëq ka problem me fibrat optike në datacenter 1. Ky është detyrim dhe shpenzim i ofruesit të shërbimit.
4. Rrjeti në shërbim të OSHIS duhet të jetë i dedikuar.
5. Rrjeti dhe shërbimi nuk duhet të prekin në asnjë mënyrë konfigurimin e tanishëm të adresave IP të rrjetit të OSHIS.
6. Ofruesi duhet të krijojë dhe garantojë brenda rrjetit të tij, një rrjet apo qark virtual për OSHIS, që do të izolojë trafikun e saj nga pjesa tjetër e këtij rrjeti. Rrjeti i ofruesit duhet të jetë transparent ndaj trafikut IP dhe me lart.
7. Shërbimi i kërkuar duhet të ofrohet në lokacionet sipas listës së mësipërme brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga firmosja e kontratës.
8. Operatori duhet të zotërojë një infrastrukturë të veten me fibër optike ose të marrë me qera.
9. Rrjeti duhet të jetë transparent ndaj mekanizmave QoS të niveleve të tjera që mund të aplikojë vetë përdoruesi (ndarja e shërbimeve në klasa, precedenca IP, rezervim bandwidth-i, Optimizim WAN-i etj).
10. Lidhja fizike duhet të jetë e menaxhueshme dhe të ketë aftësi raportuese apo alarmuese në rast difektsh apo anomalish të ndryshme.
11. Operatori duhet të garantojë zgjerim të brezit brenda 24 orësh në rast se do të kërkohet nga OSHIS.
12. Operatori duhet të jetë në gjendje që me kërkesë të OSHIS të realizojë mbrojtje me teknologji dhe (PAT) të ndryshëm të pikave të caktuara për një periudhë kohore të shkurtër.

Funksionimi i Rrjetit

-
1. Operatori duhet të ketë të paktën 6 të punësuar inxhinierë IT, telekomunikacion ose/dhe elektronik.
 2. Shërbimi duhet të ofrohet 24/7 (24 orë në 7 ditë të javës).
 3. Rrjeti i ofruar duhet të lejojë OSHIS të përdorë software dhe hardware që ajo zgjedh vetë, në funksion të aplikimeve që do të përdorë.
 4. Rrjeti duhet të jetë virtualisht i izoluar nga rrjetet e përdoruesve të tjerë.

Monitorimi i rrjetit

1. Ofertuesi duhet të dorezojë përshkrimet për Qendrën e Operacioneve të Rrjetit, strukturën e help desk-ut dhe shërbimit, dhe strukturën e vetë rrjetit.
2. Rrjeti duhet të monitorohet nga Operatori në të gjithë hallkat e tij, duke përdorur protokolle standarte të monitorimit dhe sinjalizimit.
3. Monitorimi i rrjetit dhe pajisjeve duhet të bëhen në qendër dhe nga distanca duke përdorur mjete të përshtatshme (psh SNMP për pajisje etj).
4. Operatori duhet të ofrojë shërbimin “Help Desk”. Ky shërbim konsiston në mirëmbajtjen e rrjetit, asistencë online për të gjithë problemet me rrjetin. Shërbimi Help Desk është I kontaktueshëm nga stafi i OSHIS 24/7/365 ditë të vitit, me anë të një numri telefoni kontakti të pa ndryshueshëm, ose në rast ndryshimi të lajmerohet Sektori i Menaxhimit të Shërbimeve IT pranë OSHIS duke përfshirë ditët e shtuna dhe të diela si dhe festat zyrtare në kohë reale.

Zgjidhja e problemeve

Konstatimi dhe riparimi i difekteve në linjë dhe/ose në pajisje që mundësojnë ofrimin e këtij shërbimi brenda afateve të mëposhtme:

1. Koha e përgjigjes duhet të jetë brenda 20 minutash
2. Koha e zgjidhjes së problemit në të gjithë rrjetin duhet të jetë brenda 4 orësh.
3. Mbështetje aktive në institucion deri në zgjidhjen e problemit.
4. Operatori asiston me përparësi autoritetin kontraktor si në shërbim, mjete, pajisje apo/dhe konfigurime të nevojshme.

Mirëmbajtja e rrjetit

1. Për çdo problem të mundshëm apo riparim të planifikuar që do të bëjë Operatori përkatës, duhet të lajmërojë minimumi 3 (tre) ditë para ndërprerjes, ndërsa në rastet e emergjencës apo të pa parashikuara njofton me njëhërë. Mirëmbajtja dhe riparimet e defekteve realizohen me përparësi në rradhë.

Raportimi

Ofertuesi duhet të dorëzojë raporte mujore standarte (në menyrë elektronike dhe hard copy) ku do të përshkruajë:

1. Raportin e mirëmbajtjes së rrjetit (detajimi i të gjitha kërkesave dhe veprimeve të ndërmarra në rrjet);
2. Raportin e zgjidhjes së problemeve (detajimi i të gjitha defekteve dhe zgjidhjeve që janë aplikuar).
3. Operatori Ekonomik duke të vendosë në formë të shkruar: numrat e telefonit të kontaktit si dhe adresat e e-maileve të personave të kontaktit për tu kontaktuar në cdo rast nga kontraktori.

KËRKESAT TEKNIKE TË DETYRUESHME DHE SLA (Service Level Agreement)

Operatori Ekonomik (OE) duhet të përmbushë pa përjashtim parametrat e mëposhtëm:

1. Media e transmetimit dhe Simetria: Fibër Optike (Pikë-më-Pikë) për të gjitha lidhjet. Të gjitha kapacitetet (Intranet dhe Internet) duhet të jenë Simetrike (Raporti Download i barabartë me Upload 1:1).
2. Transparenca (Layer 2): Mbështetje e plotë dhe pa limitime për teknologjitë Layer-2, përfshirë QinQ dhe VLAN Transparent. Të dhënat duhet të kalojnë në mënyrë transparente, duke lejuar komunikimin sikur pajisjet të ishin në të njëjtin switch fizik.
3. MTU (Maximum Transmission Unit): Për të evituar fragmentimin e paketave dhe për të mbështetur enkapsulimin e dyfishtë të protokolleve të Sistemit të Gjurmueshmërisë (QinQ si dhe VPN over L2), kërkohet mbështetje e detyrueshme për Jumbo Frames (MTU minimumi 1560 bytes) nga pika në pikë.
4. Disponueshmëria (Uptime/SLA): Të garantohet një disponueshmëri mujore jo më pak se 99.5%. Në rast të mos-përmbushjes së kësaj norme, do të aplikohen penalitete sipas kontratës.
5. Koha e Riparimit të Defekteve (MTTR): Maksimumi 4 orë (Mean Time to Repair) nga momenti i raportimit të problemit për gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë 24/7/365.
6. Dorëzimi fizik: Dorëzimi i shërbimit nga pajisja fundore e Operatorit Ekonomik tek pajisjet e Institucionit (MikroTik etj.) duhet të ofrohet me mundësi zgjedhjeje midis RJ45 ose SFP/SFP+, për të gjitha pikat, në varësi të portave të lira.
*Shënim: I gjithë transmetimi deri te pajisja në godinë duhet të mbetet vetem përmes Fibrës Optike.
7. Redundanca: Mbulim me lidhje të pavarur për linjën Primare dhe atë Backup (diversitet fizik në rrugëtimin e fibrës) për nyjet qendrore.

SUPORTI TEKNIK DHE MIRËMBAJTJA

-
- Monitorimi: Ofrimi i shërbimit të Mirëmbajtjes dhe Suportit Teknik 24/7/365, i cili përfshin zbulimin e problemeve paralelisht dhe raportimin proaktiv tek Institucioni (Proactive Monitoring).
 - Pajisje Fundore (CPE): Pajisja teknike fundore (Switch/Media Converter/Modul SFP) tek lokacioni duhet të sigurohet, konfigurohet dhe mirëmbahet nga OE si pjesë e shërbimit, pa kosto shtesë blerjeje apo qiraje.
 - Standartet e Sigurisë: Për shkak të natyrës kritike të të dhënave, OE duhet të dëshmojë certifikimet ISO 9001 (Cilësia), ISO 20000-1:2018 (Menaxhimi i shërbimit), ISO 27001 (Siguria e informacionit) dhe ISO 22301 (Vazhdimësia e biznesit).

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen:

Ofrimi i Infrastrukturës së Dedikuar Optike simetrike (Internet i dedikuar dhe shërbim LAN-to-LAN Layer 2 për ndërlidhjen Intranet) ndërmjet Nyjes Qendrore OSHIS (Kashar), QSUNT dhe 11 Spitaleve Rajonale (totali 13 lokacione unike fizike) dhe linja backup për disa pikat e kërkuara, me qëllim garantimin e transmetimit të sigurt e të pandërprerë të të dhënave për procesin logjistik dhe kirurgjikal të sterilizimit.

Afatet e ekzekutimit:

Shërbimi	Vendi i ekzekutimit (Lokacioni)	Afati i ekzekutimit
Internet i Dedikuar Primar - 50 Mbps	Nyja Qendrore (Kashar)	24 muaj
FIBËR L2 Intranet Primar - 100 Mbps	Nyja Qendrore (Kashar)	24 muaj
FIBËR L2 Intranet Backup - 100 Mbps	Nyja Qendrore (Kashar)	24 muaj
FIBËR L2 Intranet Primar - 100 Mbps	Qendra Spitalore Univ. Nënë Tereza	24 muaj
FIBËR L2 Intranet Backup - 100 Mbps	Qendra Spitalore Univ. Nënë Tereza	24 muaj
FIBËR L2 Intranet Primar - 50 Mbps	Spitali Shefqet Ndroqi (Sanatoriumi)	24 muaj
FIBËR L2 Intranet Primar - 50 Mbps	Spitali Ushtarak (Trauma)	24 muaj
FIBËR L2 Intranet Primar - 50 Mbps	Materniteti Koço Gliozheni	24 muaj
FIBËR L2 Intranet Backup - 15 Mbps	Materniteti Koço Gliozheni	24 muaj
FIBËR L2 Intranet Primar - 50 Mbps	Spitali Rajonal Durrës	24 muaj
FIBËR L2 Intranet Primar - 50 Mbps	Spitali Rajonal Vlorë	24 muaj
FIBËR L2 Intranet Primar - 50 Mbps	Spitali Rajonal Shkodër	24 muaj
FIBËR L2 Intranet Primar - 50 Mbps	Spitali Rajonal Burrel	24 muaj
FIBËR L2 Intranet Backup - 15 Mbps	Spitali Rajonal Burrel	24 muaj
FIBËR L2 Intranet Primar - 50 Mbps	Spitali Lushnje	24 muaj
FIBËR L2 Intranet Primar - 40 Mbps	Spitali Rajonal Dibër	24 muaj

Shërbimi	Vendi i ekzekutimit (Lokacioni)	Afati i ekzekutimit
FIBËR L2 Intranet Backup - 15 Mbps	Spitali Rajonal Dibër	24 muaj
FIBËR L2 Intranet Primar - 15 Mbps	Spitali Korçë	24 muaj
FIBËR L2 Intranet Primar - 10 Mbps	Spitali Rajonal Tropojë	24 muaj

Afatet e kryerjes së shërbimit

Instalimi dhe Shërbimi i kërkuar duhet të ofrohet në Lokacionet sipas listës së mësipërme brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga momenti i nënshkrimit të marreveshjes kuader.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Objekti i këtij shërbimi është ofrimi i infrastrukturës së dedikuar optike (Fibër LAN-to-LAN Layer 2 dhe Internet i Dedikuar) për një periudhë prej 24 muajsh nga momenti i nënshkrimit të marreveshjes kuader.

Qëllimi parësor është ndërlidhja e sigurt, e mbyllur dhe e pandërprerë e Nyjes Kryesore (Kashar) me 12 struktura e qendra të tjera rajonale spitalore në Republikën e Shqipërisë (në total 13 lokacione fizike). Të gjitha linjat, qofshin ato Internet apo Intranet, duhet të jenë Simetrike (Raporti Download/Upload 1:1). Ky rrjet garanton transmetimin në kohë reale të të dhënave, backupin live të shërbimeve kritike midis Nyjes Qëndrore (Kashar) dhe Nyjes së Backupit (QSUNT), komunikimin e pajisjeve thelbësore, me qëllim vijimin pa ndërprerje të procesit kombëtar të gjurmueshmërisë dhe sterilizimit të instrumenteve kirurgjikale.

Detyrat e Operatorit Ekonomik:

Gjatë periudhës 24-mujore të marreveshjes kuader, Operatori Ekonomik ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- Ofrimi i Kapacitetit: Të garantojë në çdo kohë 100% të bandwidth-it (kapacitetit) të kërkuar dhe Simetrik (Internet 50Mbps; si dhe Intranet L2 sipas tabelës së lokacioneve).
- Transparenca L2 & QinQ: Të mundësojë shërbim transparent nga Pikë në Pikë. Të kalojë teknologjinë VLAN Transparent / 802.1Q (QinQ) pa cënuar, fshirë, filtruar apo rregulluar asnjë IP të brendshme, apo rrugëtim (routing) të OSHIS. Shërbimi ofrohet si Layer 2 transparent.
- MTU (Maximum Transmission Unit): Rrjeti mbajtës i operatorit duhet të suportojë Jumbo Frames pa shkaktuar fragmentim. Paketat duhet të lejohen në dimensionet mbajtëse me MTU me minimum prej 1560 Bytes.
- Besueshmëria dhe Gatishmëria (SLA): Të garantojë një normë Disponueshmërie (Uptime) vjetore jo më të vogël se 99.5%.
- Koha e Reagimit (MTTR): Operatori duhet të mbajë stafin në gatishmëri teknike të provuar 24 orë në ditë, 7 ditë në javë, 365 ditë në vit. Në rast rënie ose prerje fizike të fibrës kudo në Republikën e Shqipërisë, Koha e Riparimit të Defektit (MTTR) nuk duhet të kalojë në asnjë rrethanë 4 orë nga njoftimi fillestar. Kalimi i këtij pragu prodhon penalitete sipas kontratës.
- Mirëmbajtja e Pajisjeve (CPE): Pajisjet Switch apo Media Converter e modulare që Operatori lë në ambientet spitalore shërbehen, ndërrohen në rast djegieje/defekti dhe mirëmbahen nga vetë Operatori, me koston e tij gjatë 24 muajve.

Shpërndarja:

- Arkitektura e rrjetit logjik bazohet në topologjinë e centralizuar (Point-to-Multipoint) me një qendrore në Autostradën Tiranë-Durrës, Km.5 (Kashar).
- Shërbimi mbetet ekskluzivisht Intranet, asnjë port L2 në Spitalet Rajonale nuk lejohet të ketë hapje apo urrëzim të fshehtë jashtë kontratës drejt Internetit Global (kjo garantohet duke mos patur ndërhyrje Layer-3 në kalim).
- Shpërndarja e linjave Backup, në ato Spitale ku është kërkuar si i tillë në Tabelë, duhet të realizohet detyrimisht duke përdorur rrugëzime optike dytësore (ndarje gjeografike apo rrjete redundante fizike/kanale të veçanta) dhe jo mbi po të njëjtën fije optike kryesore.

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve:

Dorëzimi fizik i sinjalit përfundimtar realizohet ekskluzivisht brenda dhomave inxhinierike të Serverave (Rrack-eve të Komunikimit) brenda çdo ndërtese spitalore/mjekësore/centrali te OSHIS.

Afati i aktivizimit të shërbimit është maksimumi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga dita e nënshkrimit të Marrëveshjes/Kontratës mes palëve, në këto lokacione:

1. Nyja Qendrore (Kashar) - Mëzez, Autostrada Tiranë-Durrës, Km.5, Tiranë
2. Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza (QSUNT)
3. Spitali Shefqet Ndroqi (Sanatoriumi)
4. Spitali Ushtarak (Trauma)
5. Materniteti Koço Gliozheni
6. Spitali Rajonal Durrës
7. Spitali Rajonal Vlorë
8. Spitali Rajonal Shkodër
9. Spitali Rajonal Burrel
10. Spitali Lushnje
11. Spitali Rajonal Dibër
12. Spitali Korçë
13. Spitali Rajonal Tropojë

Dorëzimi (Handoff) i fundit elektronik nga Media Converter-i i Operatorit tek pajisjet e Autoritetit Kontraktor (Kryesisht MikroTik CCR/RB) bëhet me Fije direkt Optike (Modul SFP/SFP+) dhe finalizohet me Procesverbalin e Kolaudit, ku vërtetohet nga stafi IT kalimi funksional simetrik me VLAN Transparent në tërësinë e 13 pikave kombëtare, përfshirë kapacitetet perkatëse.

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë/Autorizim të përgjithshëm nga AKEP për të gjitha shërbimet e kërkuara në këtë procedurë.

2.1.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesi Çertifikatë me standardet ISO 9001:2015, ose e përditesuar për Menaxhimin e Cilësisë, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në emër të ofertuesit, e vlefshme.

2.1.3 Operatori Ekonomik duhet të disponojë Çertifikatë të vlefshme ISO 20000-1:2018 ose e përditesuar për Sistemin e Menaxhimit të Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit. Çertifikata duhet të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga

organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në emër të ofertuesit.

2.1.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë çertifikatë të vlefshme me standardet ISO 22301:2019 ose e përditësuar për Sistemin e Menaxhimit të Vazhdimësisë së Biznesit (Business Continuity Management System). Çertifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.1.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesi Çertifikatë me standardet ISO 27001:2022 ose e përditësuar për Menaxhimin e Sigurisë së Informacionit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në emër të ofertuesit, e vlefshme.

2.1.6 Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 2 (dy) lidhje ndërkombëtare për shërbimin e Internetit. Për të vërtetuar këtë pikë, Operatori ekonomik duhet të paraqesë një kopje të kontratës/marrëveshjes ose dokument alternativ, me subjektet jashtë territorit të Shqipërisë mbi përdorimin e Aksesit Global në Internet.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit** të Marrëveshjes Kuadër.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit të Marrëveshjes Kuadër, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik për zbatimin e kontratës duhet të ketë të punësuar në stafin e tij jo më pak se 6 (gjashtë) inxhinier të diplomuar në fushën e telekomunikacionit dhe/ose Elektrike dhe/ose Elektronike dhe/ose Teknologji informacioni që do të kryejnë shërbimin e konfigurimit dhe instalimit të shërbimit. Inxhinieret duhet të kenë certifikimet si më poshtë:

-
- Të paktën 2 (dy) Inxhinier të paisur me Certifikatë (MTCRE) MikroTik Routing ose ekuivalent.
 - Të paktën 3(tre) Inxhinier të paisur me Certifikatë (MTCNA) ose ekuivalent.
 - Të paktën 1(një) Inxhinier të certifikuar për IT Infrastrukturë Service Management ITIL

Për këta punonjës duhet të paraqitet:

- Diplomë përkatëse
- Kontratë pune e vlefshme
- Certifikatat perkatëse.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të zotërojë një infrastrukturë të vetën me fibër optike, ose në rast se operatori nuk disponon një infrastrukturë të vetën me fibër optike për të gjithë pikat e kërkuara në këto specifikime, atëherë operatori duhet të paraqesë kontratë qiraje/marrëveshje bashkëpunimi me një operator të licensuar nga AKEP-i. Kjo kontratë e qirasë/marrëveshje bashkëpunimi, në rastin e marrjes së këtij shërbimi, duhet të dokumentohet për ofrimin e shërbimit në pikat fundore sipas specifikimeve teknike të procedurës.

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

